



## **Përditësim për shtypin**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për të urdhëruar Prokurorinë që të nxjerrë pesë kategori informacioni. Mbrojtja e Thaçit dhe Prokuroria nuk u pajtuan nëse informacioni i kërkuar ishte objekt i detyrimeve për nxjerrje të materialit.

Gjykatësi i Vetëm theksoi se procedura e duhur në lidhje me nxjerrjen e materialit përcakton që fillimisht Prokuroria duhet të paraqesë njoftim të hollësishëm për çdo material dhe provë që posedon. Bazuar në këtë njoftim, Mbrojtja mund të kërkojë nxjerrjen e materialit konkret dhe, në qoftë se Prokuroria nuk pajtohet, mund ta ngrenë këtë aspekt para Trupit Gjykses.

Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Prokurorinë të dorëzojë njoftim të përditësuar ku renditen dokumentet, nëse ka, nga pesë kategoritë që kërkon Mbrojtja e Thaçit.

Gjykatësi i Vetëm theksoi se Rregullorja parasheh disa kufizime në lidhje me detyrimet e Prokurorisë për nxjerrje të materialit. Ndër to përfshihen, për shembull, transkriptet e diskutimeve të brendshme ose memorandumeve të brendshme.

Në këtë çështje gjyqësore janë planifikuar seanca gjatë javës 11-15 maj, nga ora 9:30 deri në orën 16:30.





Më 30 prill, Gjykatësi i vetëm miratoi një kërkesë të Isni Kilajt, Bashkim Smakajt dhe Hajredin Kuçit që në seancat e ardhshme të paraqitjes së provave nga Mbrojtja të marrin pjesë nga distanca, përmes videolidhjes.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 23 prill 2026, Mbrojtja e Rexhep Selimit dorëzoi versionin e redaktuar publik to dosjes së saj përfundimtare, e cila ishte dorëzuar më parë si konfidenciale në janar 2026. Kjo dosje përfundimtare e Mbrojtjes ishte e fundit që ende nuk ishte bërë publike.

Aktualisht, Trupi Gjykses në këtë çështje gjyqësore është në fazën e kuvendimeve. Afati për nxjerrjen e aktgjykimit varet nga secila çështje. Rregullorja përcakton se Trupi Gjykses ka 90 ditë për të arritur një verdikt, por mund të shtyjë kuvendimet përtej 90 ditëve në rast se, për shkak të rrethanave, kërkohet më shumë kohë. Data e saktë e shpalljes së verdiktit në këtë çështje nuk dihet ende por publiku do të njoftohet kur gjykatësit të caktojnë datën.

Në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave (rregulla 159), Trupi Gjykses nuk është i detyruar të “kërkojë” zgjatje të afatit. Megjithatë, ai duhet të paraqesë vendim të arsyetuar për këtë. Rregullorja nuk përcakton afat konkret për lëshimin e këtij vendimi.

